



Republika e Kosovës - Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština- Assembly



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

**MARRËVESHJE PËR LLOGARI
TË MIRËBESIMIT NË MES TË
KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS DHE SHTETEVE TË
BASHKUARA TË AMERIKES**

**MARRËVESHJE PËR
LLOGARI TË MIRËBESIMIT
NË MES TË KUVENDIT TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE SHTETEVE TË
BASHKUARA TË AMERIKËS**

Datë: 2 Dhjetor 2016

Kuvendi i Republikës së Kosovës (“Përfituesi”) dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke vepruar përmes Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar (“USAID”),(në vazhdim, “Palët”), shprehin dëshirë të hyjnë në Marrëveshje për Llogari të Mirëbesimit (“Marrëveshja”).

Prandaj, palët pajtohen si në vijim:

1. Qëllimi

Përfituesi dhe USAID dëshirojnë t’i ofrojnë asistencë zhvillimore Kuvendit të Republikës së Kosovës (KRK), për ta implementuar projektin për Mbështetjen e Aktiviteteve të Hulumtimeve Parlamentare (“Aktivitetet”) të financuar nga USAID-i. Këto aktivitete do ta përmirësojnë cilësinë e legjislacionit, duke i shfrytëzuar hulumtimet dhe analizat. Qëllimi është arritja e vendimeve gjithëpërfshirëse, të bazuara në prova në procesin e krijimit të politikave kombëtare që do të rezultojnë në përmirësimin e cilësisë së legjislacionit.

Kjo marrëveshje nuk merr përsipër obligim financiar të ri nga Republika e Kosovës. Obligimi financiar është definuar nga Kuvendi me Ligjin nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 dhe Ligjin nr.05/L-[109 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.05/L-071 për Buxhetin e Republikës të Kosovës për vitin 2016.](#)

2. Themelimi i Llogarisë së Mirëbesimit

Në mënyrë që të implementohet programi, Palët pajtohen që ta themelojnë një llogari të veçantë bankare (“Llogaria e Mirëbesimit”).USAID-i pajtohet të veprojë si Kujdestar i fondeve që do të mbahen në Llogarinë e Mirëbesimit (“Fondi i Mirëbesimit”), në emër të Përfituesit.

Llogaria e Mirëbesimit do të themelohet në Raiffeisen Bank Kosovë Sh.A. Llogaria e Mirëbesimit do të hapët në emër të Qeverisë së SHBA-ve, që vepron përmes USAID-it.

Pas themelimit të Llogarisë së Mirëbesimit, Përfituesi do të transferojë dhe deponojë 20,000 (njëzet mijë) euro në Llogarinë e Mirëbesimit, me një këst të vetëm, jo më vonë se më 31 dhjetor 2016. Llogaria e Mirëbesimit do të jetë një llogari që përfiton kamatë. Fitimet nga kamata do t’i shtohen Llogarisë së Mirëbesimit dhe do të jenë të disponueshme për shpenzime, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

3. Shfrytëzimi i Fondeve të Mirëbesimit

Fondet e Mirëbesimit do të përdoren për qëllimet e përkrahjes së Aktivitetit. Tri objektivat e Aktivitetit janë:

1. Përmirësimi i cilësisë së legjislacionit duke përdorur hulumtime dhe analiza;
2. Rritja e kapacitetit profesional për të kryer analiza cilësore të legjislacionit;
3. Rritja e pjesëmarrjes dhe inputit të shoqërisë civile në procesin legjislativ dhe procesin ligjvënës.

USAID-i do ta kërkojë pëlqimin e Përfituesit për nën-detyrimin e tij për fondet dhe do ta shfrytëzojë Fondin e Mirëbesimit për t'ia rimbursuar partnerit implementues shpenzimet e bëra gjatë zbatimit të aktiviteteve.

4. Procedurat e shpërndarjes

Fondet e Mirëbesimit do të pranohen në pajtim me Pjesën 635(b) të Aktit për Ndihmë të Jashtme të vitit 1961, siç është amendamentuar ("ANJ"), dhe do të mbahen, menaxhohen dhe shpërndahen në pajtim me kërkesat e ANJ-së dhe kërkesat ligjore të politikave dhe procedurave të USAID-it.

5. Disponueshmëria e fondeve

Fondet e Mirëbesimit të vëna në dispozicion përmes Llogarisë së Mirëbesimit do të mbesin në dispozicion derisa të shpenzohen, përveç nëse anulohet Llogaria e Mirëbesimit.

6. Shfuqizimi i Marrëveshjes

Marrëveshja do të mbetet në fuqi derisa të shfuqizohet përmes marrëveshjes së dyanshme me shkrim nga USAID-i dhe Përfituesi, apo deri në përfundimin e Aktivitetit, cila do që ndodh më parë. Shfuqizimi i Marrëveshjes do të anulohet obligimet e Palëve lidhur me Llogarinë e Mirëbesimit, përveç obligimeve që kanë dalë në pajtim me zotimet që nuk mund të anulohen e në të cilat është hyrë me palët e treta para shfuqizimit të Marrëveshjes.

Në rast të një shfuqizimi të tillë të Marrëveshjes, Fondet e Mirëbesimit të cilat nuk janë zotuar në pajtim me obligimet të cilat nuk mund të anulohen e në të cilat është hyrë me palët e treta para shfuqizimit, do t'i kthehen Përfituesit.

7. Shënimet dhe inspektimi

USAID-i do të mbajë shënime për gjitha shpërndarjet nga Llogaria e Mirëbesimit. Shënimet e tilla do të mbahen për një periudhë trevjeçare pas shpërndarjes së fundit nga Llogaria për aktivitetet e financuara nga ajo dhe mund të inspektohen nga përfaqësuesit e Përfituesit në çfarëdo kohe te arsyeshme.

8. Raportimi

USAID-i do ta përgatisë një raport final pas përfundimit të Aktivitetit për Përfituesin, ku do të evidentohen shumat dhe datat e depozitave të bëra në Llogarinë e Mirëbesimit, si dhe

shumat e disbursuara (tërhequra) nga Llogaria e Mirëbesimit gjatë kohëzgjatjes së Aktiviteteve, dhe nëse ka, bilancin e mbetur në Llogarinë Mirëbesimit. Raporti do të përgatitet për Përfituesin dyzet e pesë ditë pas përfundimit të jetëgjatësisë së Aktivitetit.

9. Bashkëpunimi në mes të palëve

USAID-i dhe Përfituesi do të bashkëpunojnë për të siguruar zbatimin e qëllimeve të Marrëveshjes. Secila Palë do t'i emërojë personat përgjegjës për koordinimin dhe rishikimin periodik të progresit të Projektit “Mbështetja e Aktiviteteve të Hulumtimeve Parlamentare”.

10. Përfaqësuesit

Për të gjitha qëllimet që janë relevante për këtë Marrëveshje, Përfituesi do të përfaqësohet nga kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe USAID-i do të përfaqësohet nga personi që mban ose ushtron detyrën e drejtorit të Misionit të USAID-it në Kosovë. Secili përfaqësues mund të emërojë edhe përfaqësues të tjerë për qëllimet e lartcekura. Secila Palë do të ofrojë emrat e personit ose personave të tillë shtesë, duke njoftuar me shkrim palën tjetër, njoftim ky i cili duhet të jetë i nënshkruar. Palët mund ta pranojnë si të autorizuar cilindo instrument të nënshkruar nga këta përfaqësues në implementimin e kësaj marrëveshjeje deri në pranimin e njoftimit me shkrim për shfuqizim të autorizimit të tyre.

11. Komunikimi

Cilido njoftim, kërkesë, dokument, ose komunikim tjetër i dorëzuar nga Përfituesi ose USAID-i te Pala tjetër nën këtë Marrëveshje, duhet të jetë me shkrim dhe do të konsiderohet si i dhënë ose i dorëzuar kur të dërgohet te Pala tjetër në adresat vijuese:

Për Përfituesin:

Adresa postare: Kryetari, Kuvendi i Republikës
së Kosovës
Rruga: Nëna Terezë
10000 Prishtinë
Telefoni: 038 211 366
Fax: 038 211 367

Për USAID-in:

Adresa postare: Drejtori i Misionit, USAID/Kosovë
Arbëria, Rr. Ismail Qemali, shtëpia # 1, 10000
Prishtinë, Telefoni: 038 243 673
Fax: 038 249 493

Të gjitha këto komunikime do të jenë në gjuhën angleze, përveç nëse palët merren vesh ndryshe me shkrim. Adresat mund të ndërrohen pas njoftimit me shkrim ndaj palës tjetër.

12. Lidhja me Kornizën e Marrëveshjes Bilaterale

Asistenca e sipërpërmendur është pjesë e programit të Qeverisë së SHBA-ve për asistencë për Kosovën nën Marrëveshjen për Bashkëpunim Ekonomik dhe Teknik ndërmjet Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës së Kosovës, të datës 29 mars 2012, dhe Marrëveshjes së Ndryshuar dhe Ritheksuar për Asistencë ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës së Kosovës, të datës 2 shtator 2010, sipas ndryshimeve dhe plotësimeve, dhe do t'i nënshtrohet kushteve dhe termave të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë dispozitat që kanë të bëjnë me lirimin nga tatimet dhe obligimet doganore.

13. Ndryshimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm përmes marrëveshjes me shkrim dhe të nënshkruar nga të dyja palët.

14. Gjuha

Kjo Marrëveshje e Llogarisë të Mirëbesimit do të përgatitet në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Në rast të dykuptimisë apo mospajtimit në mes të versioneve, versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë.

15. Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit dhe do të mbetet në fuqi derisa palët të vendosin ta shfuqizojnë Marrëveshjen me pëlqim të dyanshëm apo deri në përfundimin e aktivitetit.

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

Nga:

Nga:

Emri: Kadri Veseli

Emri: James Hope

Kryetar i Kuvendit të Kosovës

Drejtor i Misionit të USAID-it